



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr. 45, datë 19.03.2019

PËR PRAKTIKËN PROFESIONALE TË KANDIDATËVE PËR MAGJISTRATË TË SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS

Në mbështetje të neneve 14 dhe 33 të Ligjit nr.96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, bazuar në kërkesën, informacionin dhe materialet e dërguara nga Shkolla e Magjistraturës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

VENDOSI:

1. Të caktojë/miratojë Prokurorinë Pranë Gjykatë së Shkallës së Parë Tiranë që do të shërbejë për kryerjen e praktikës profesionale për kandidatët magjistratë, profili prokuror, të vitit akademik 2017- 2018, 2018 - 2019 dhe 2019-2020.
2. Të caktojë/miratojë magjistratët prokuror udhëheqës për një periudhë trevjeçare (2017-2020), me të drejtë riemërimi, sipas listës bashkëngjitur.
3. Magjistratët prokuror udhëheqës sipas pikës 2 të këtij vendimi, të angazhohen menjëherë për të ndjekur trajnimet e nevojshme pranë Shkollës së Magjistraturës.
4. Të caktojë, për periudhën 1 mars 2019 - 30 qershor 2019 magjistratët prokurorë udhëheqës, për kandidatët për magjistratë profili prokuror, për vitin akademik 2018-2019, sipas listës bashkëngjitur.
5. Magjistrati prokuror udhëheqës do të bëjë vlerësimin etik dhe profesional të secilit kandidat magjistratë, profili prokuror, sipas formularëve bashkëngjitur këtij vendimi, duke u bazuar në kriteret dhe nivelet e vlerësimit, të përcaktuara në ligj.
6. Magjistrati udhëheqës prokuror, sipas pikës 4 të këtij vendimi, të përjashtohet nga hedhja e 10-të e shortit, të organizuar gjatë periudhës 1 mars 2019 - 30 qershor 2019, për ndarjen e çështjeve në prokurorin pranë të cilës ushtron funksionin.



7. Magjistrati prokuror udhëheqës, përgjatë periudhës përkatëse që ushtron këtë veprimtari, përfiton 5 për qind shtesë page mbi pagën mujore bruto fillestare të tij. Shtesa e pagës për magjistratin prokuror udhëheqës i shtrin efektet nga data 1 mars 2019.
8. Gjatë praktikës profesionale, kandidati për magjistrat, profili prokuror, gëzon të drejtën e pushimeve vjetore të paguara në kohëzgjatjen 25 ditë pune, nga të cilat, 15 ditë pune merren gjatë muajit gusht, në të njëjtën kohë me magjistratin udhëheqës. Drejtuesi i prokurorisë jep pushimet vjetore, pasi konsultohet me magjistratin prokuror udhëheqës të tij.
9. Për këtë vendim njoftohen Shkolla e Magjistraturës, Prokuroria Pranë Gjykatë së Shkallës së Parë Tiranë, dhe magjistratët prokuror udhëheqës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI



GENT IBRAHIMI